



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 8 datë 30/04/2014

PËR

“SHPREHJEN E APROVIMIT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË GODINËS SË ISH-DREJTORISË SË KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME TË TIRANËS, GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT, TIRANË, SIPAS KËRKESËS SË MINISTRIT TË DREJTËSISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 6 pika 2, nenit 7, nenit 8, pika 1/I, shkronja “b”, nenit 32, shkronja “e” dhe nenit 33, pika 4 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); vendimit nr. 502, datë 16.04.2008 “Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.834, datë 13.12.2006 për “Miratimin e Listës së Pjeshme të Inventarit (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme shtetërore, në Bashkinë Tiranë, të Qarkut Tiranë”, si dhe bazuar në kërkesën e Ministrit të Drejtësisë me nr.prot. 2582/2, datë 18.04.2014 drejtuar Bashkisë së Tiranës për shprehjen e aprovimit nga Kryetari i Bashkisë së Tiranës për dhënie në përdorim të godinës së ish-Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Shprehjen e aprovimit për dhënie në përdorim pa kundërshpërblim të godinës së ish-Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme të Tiranës, Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë deri në ndërtimin e Pallatit të Drejtësisë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI